



01 Nr. 78021 Dt. 19.12.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data/Date:	19.12.2023
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit dhe hartimin e Projekt-Planit të Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Prizrenit

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17- Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me 13.04.2023, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Planin e Vlerësimit të Rrezikut në Komunën e Prizrenit, pjesë e grupit janë: Ramize Shala, kryesuese; Urim Daka, anëtarë; Haziz Krasniqi, anëtarë; Përparim Shala, anëtarë; Rrahim Destani, anëtarë; Sami Vehapi, anëtarë; Halil Lika, anëtarë; Jahja Baca, anëtarë; Fatlum Berisha, anëtarë; Enver Kryeziu, anëtarë; Artan Gashi, anëtarë; Jakup Kastrati, anëtarë; Zana Belloda, anëtare; Sherife Çengaj, anëtare; Vetan Xhemaj, anëtarë; Sherif Sallahu, anëtarë; Vehbi Zekolli, anëtarë; Fejzullah Berisha, anëtarë; Urim Bytyqi, anëtarë; Ismail Krasniqi, anëtarë; Xhevdet Elezkurtaj, anëtarë; Hekuran Vezgishti, anëtarë; Kujtesa Godeni-Skenderi, anëtare; Riza Poniku, anëtarë; Përfaqësues i FSK-së, anëtarë dhe Eroll Shabani-OJQ Ec Ma Ndryshe, anëtarë.

-Me 24.04.2023, është mbajtur takimi i parë i grupit punues, në këtë takim të pranishëm kanë qenë: Ramize Shala, kryesuese; Urim Daka, anëtarë; Haziz Krasniqi, anëtarë; Përparim Shala, anëtarë; Sami Vehapi, anëtarë, Halil Lika, anëtarë; Jahja Baca, anëtarë; Zana Belloda, anëtare; Sherife Çengaj, anëtare; Sherif Sallahu, anëtarë; Vehbi Zekolli, anëtarë; Urim Bytyqi, anëtarë; Ismail Krasniqi, anëtarë; Xhevdet Elezkurtaj, anëtarë; Hekuran Vezgishti, anëtarë; Kujtesa Godeni-Skenderi, anëtare; Eroll Shabani-OJQ Ec Ma Ndryshe, anëtarë.

Gjatë takimit, Ramize Shala, kryesuese ka njoftuar anëtarët e komisionit se detyrat dhe përgjegjësit e tyre janë që mbledhin të dhëna për drejtorinë apo institucionin që e përfaqësojnë dhe se ky dokument është i një rëndësie të veçantë dhe se qëllimi i këtij takimi është që t'ju njoftojmë për procedurat e përgatitjes së këtij plani dhe përgjegjësit që kemi të gjithë ne si pjesë e këtij grupi. Ne si anëtarë do të përgatisim të dhëna për secilin institucion që e përfaqësojmë dhe ato informacione do të kërkohen nga koordinatori i këtij grupi dhe më pas ato të dhëna do të jenë pjesë e dokumentit final.

Gjithashtu kryesuesja Shala ka thënë se në mungesë të profesionistëve në komunë, për fusha që kërkohen në përgatitjen e këtij dokumenti, për përgatitjen e këtij dokumenti do të shkojmë me procedurë tenderuese.

Ndërsa anëtarët e grupit kanë kërkuar që pjesë e grupit punues duhet të jenë edhe zyrtarë të institucioneve tjera si Instituti Kombëtarë i shëndetit Publik dhe nga AME-ja. Gjithashtu ata thanë se të dhënat që kërkohen nga koordinatori, do ti dërgojmë sipas afateve të kërkuara.

Në këtë takim Haziz Krasniqi, anëtar i këtij grupi punues është caktuar edhe koordinatori i grupit.

Lajmi për mbajtjen e takimit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-takimi-i-pare-i-grupit-punues-per-planin-e-vleresimit-te-rrezikut-ne-komunen-e-prizrenit/>

Me 28.08.2023, është mbajtur takimi i parë me përfaqësuesin e kompanisë e cila do ta hartoj dokumentin: Projekt-Planin e Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Prizrenit. Në këtë takim të pranishëm kanë qenë Ramize Shala, drejtoreshë për Emergjencë dhe Siguri; Urim Daka, Zyrtar për Emergjencë dhe Siguri; Haziz Krasniqi, zyrtar i Lartë për Informim dhe Idriz Shala, përfaqësues i kompanisë.

Gjatë takimit është diskutuar për fillimin procedurave për hartimin e dokumentit dhe mbajtjen e një takimi me gjithë anëtarët e grupit punues, në mënyrë që të njihen me punën të cilën do të bëjnë të gjithë anëtarët e këtij grupi.

Në të njëjtën ditë Idriz Shala, e ka dërguar dokumentin kornizë me përmbajtjen e dokumentit kornizë sipas kërkesave të AME-së që do të jetë bazë për fillimin e punës në projektin e Vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në komunën e Prizrenit.

Me 03.09.2023, zyrtari Idriz Shala ka nisur dërgimin e emailave ku ka kërkuar të dhëna nga drejtoritë.

Me 20.09.2023, grupi punues për hartimin e Projekt-Planin e Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Prizrenit mbajti takimin e dytë të radhës. Gjatë takimit grupi punues për Hartimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikut për Komunën e Prizrenit ka mbajtur takimin e dytë të radhës, në këtë takim thelbësor është prezantuar dhe diskutuar Planin e Rrezikut të komunës. Në këtë takim të pranishëm ishin Ramize Shala, drejtoreshë e Emergjencave dhe Sigurisë, njëherit edhe kryesuese e grupit dhe anëtarët tjerë të grupit punues.

Grupi punues, i cili është formuar nga kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj dhe ka për qëllim identifikimin dhe zbatimin legjislativ që ka të bëjë me menaxhimin e rreziqeve të ndryshme në komunën e Prizrenit. Hartimi i këtij plani ka për qëllim parandalimin, zbutjen dhe menaxhimin e situatave të rrezikshme që mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm si tërmete, përmytje, ndotja e mjedisit, dhe rreziqe të tjera natyrore dhe antropogjene.

Ky plan është një hap i rëndësishëm drejt sigurisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunës dhe do të përdoret nga zyrtarët komunal si një mjet udhëzues për menaxhimin e rreziqeve në të ardhmen.

Pas përfundimit të hartimit të këtij plani, i njëjti do të miratohet në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe do të jetë në dispozicion të publikut për njohuri dhe përdorim.

Zyrtarët Idriz Shala dhe Burim Gashi, zyrtar nga Operatori Ekonomik Globi Consulting, kanë prezantuar në pika të shkurtëra të gjithë punën e bërë në hartimin e planit duke thënë se hartat dhe të dhënat janë formuar të veçanta veç për komunën e Prizrenit, gjithashtu në këtë plan do të ketë edhe të dhëna të vjetra.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **03:12.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/12/Njoftimi-per-konsultim-publik.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/12An8q8xrnQ/>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-planin-e-vleresimit-te-rrezikshmerise-nga-fatkeqesite-natyrore-dhe-fatkeqesite-tjera-per-komunen-e-prizrenit/>

Platforma:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42720>

Me 04.12.2024, njoftimi dhe plani (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 11.12.2023, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e lajmi për mbajtjen e konsultimit:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/mbahet-konsultim-publik-per-projekt-planin-e-vleresimit-te-rrezikshmerise-nga-fatkeqesite-natyrore-dhe-fatkeqesite-tjera-per-komunen-e-prizrenit/>

13.12.2024, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data 03.12.2024 deri me 18.12.2024, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë 18.12.2023.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
I-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Raporti për: Projekt-Planin e Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Prizrenit	11.12.2024 Nga-11:10 Deri-12:00	F 5 M 18 T 23	8	2-Pjesërisht 0-Refuzohen 3-Pranuar 3-Adresuar

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës: Pranuar: Pjesërisht: Refuzuar: Adresuar	Arsyetimi i Komisionit i hartuar me datë 18.12.2024 për pranimin e kërkesave të qytetarëve
1	“ATV Adrenalina” shpreh gatishmërinë dhe vullnetin për të dhënë kontributin e saj për të mirën e përbashkët të qytetit tonë. Kompania jonë zotëron 7 motorra ATV të specializuar për terrene të vështira malore dhe kushte të pafavorshme si borë, shi dhe shtigje të thepisura. Ky lloj mjeti transportues mund të jetë një vlerë e shtuar për rastet emergjente dhe për të mbështetur ekipet tuaja në situata të veçanta. Përfitimet nga motorët tanë ATV për Komunën e Prizrenit dhe komunitetin përfshijnë: Transportim i shpejtë i personelit mjekësor në zona të paarritshme me automjete të zakonshme. Dërgimi i paketave emergjente, si ushqime, ujë dhe materiale të tjera të nevojshme në raste krizash. Mbështetja e stafit policor dhe ekipeve të zjarrfikësve, duke përfshirë transportimin e personelit, pajisjeve të punës dhe burimeve të tjera të domosdoshme. Reagim i shpejtë në raste të fatkeqësive natyrore, duke lehtësuar arritjen në vendndodhjet më të izoluara të komunës, si fshatra malore apo terrene të thella.	Blerim Gashi nga kompania “ATV Adrenalina”	Pranuar	Duke pasur parasysh territorin e komunës së Prizrenit si dhe ndryshimet klimatike që po paraqesin situata emergjente në male si dhe në zona të thepisur, reagimi i shpejtë në këto raste është i domosdoshëm. Rëndësi të veçanta ka specializimin (përdorimi i motorëve) dhe ndihma që mund të ofrohet në raste të tilla. Pavarësisht se Brigada e zjarrfikësve ka dy motorra malor, në raste emergjente është e nevojshme edhe ndihma e ofruar nga qytetarët.

2	Pikat në të cilat ne mund të kontribuojmë janë e që janë në raste emergjente: Motorrat e kompanisë sonë janë me katër rrota dhe ata shkojnë nëpër terena ma të theksume malore, në shi, në borë në të gjitha kushtet, pra janë shumë praktik dhe të specializuar për me shku në terrene ku nuk shojnë makinat normale apo edhe zyrtare. Ne kemi parashikuar që në bashkëpunim me ekipet e rasteve emergjente si : personeli mjekësor nëpër fshatra të ndryshme në raste të caktume, paketa emergjente, motorrat kanë bagazh dhe mund të transportojmë edhe disa kilogram me paketa të ndryshme, ekipe mjekësore, ekipe emergjente, ekipe policore pra të gjitha në koordinim me ekipet emergjente, se çka neve mund të ofrojmë, kjo për faktin se ne jemi prezent në gjitha bjeshkët e Prizrenit, duke marrë parasysh nga Guri i Zi, Pashtrik dhe të gjitha bjeshkët që janë përreth . E shohim se cila makinë mund të shkoj dhe cila nuk mund të shkoj, ne jemi prezent aty ku nuk shkojnë makinat ma ushtarake këtu pse edhe ne të japim një pikë-ndihmë. Ne nuk posedojmë ekip personal, përveç motorrave ne nuk kemi njerëz, nëse komuna e sheh të arsyeshme në bashkëpunim me ekipet emergjente, ne i kemi pikat se çka mund të bëjmë, ti trajnojmë ekipet e caktume nga komuna që mund ti marrin motorrat 24 orë në dispozicion për rast nevojë (FSK, Policia, Zjarrfikësit), secila ekipe mundet me pas motrorrin, ne mund t'ja ofrojmë trajnimin dhe ata mund ti marrin motorrat në raste emergjente. Kjo është ajo që ne e kemi planifikuar për ndihmë për nevojat e qytetit të Prizrenit.	Gzim Gashi nga kompania “ATV Adrenalina	Pranuar	Gjatë incidenteve emergjente është shumë e rëndësishme të njohim terrenin për shkak se duhet të sigurojmë jetën e ekipeve të cilët intervenojnë andaj ideja për bashkëveprim dhe huazim të mjeteve motorikë është më se e nevojshme si në raste për kërkim shpëtim poashtu në borë dhe shi. Andaj ky propozim pranohet.
3	Disa here kemi bërë kërkesë ne Kuvendin Komunal te Prizrenit per te reshurat atmosferike, kam kontaktuar edhe me drejtoreshën Ramize Shala si dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike qe disa vite qe nga koha kur është ndërtuar autostrada e cila kalon perfundi fshatit Shpenadi ne te cilën është ngrit niveli i tokës për shkak te hedhjes se gurëve te shumte dhe kur ka vërshime dëmtohet familja Shtufi nga te reshura. Ka nevojë per nje siguri te veqante ne te cilen duhet te eliminohet kjo dukuri qe çdo vit po ndodh me një mur mbrojtës me thellu lumin qe është ngrit gjate punimeve te autostrades.	Simon Veseli	Adresuar	Duke e pasur parasysh buxhetin e vogël të drejtorisë nuk kemi mundësi të intervenojmë në këtë rast, pasi që DES intervenon vetëm në raste kur rreziku është permanent. Andaj kjo çështje duhet të adresohet në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pasi që drejtoria në fjalë ka një kod për intervenime në raste të tilla.
4	Jemi te gatshëm të jemi pranë institucioneve ku Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë ju kemi ofruar gjithmonë alternative për specialiste te fushës sonë për trajnime për mbrojtjen nga rreziqet e ndryshme. Kemi obligim moral me i mbështet institucionet.	Agron Tafa, kryetar i shoqatës se pensionistëve te TMK-se, FSK-se ne Prizren	Pranuar	Me shoqatën e pensionistëve të TMK-FSK-ë në Prizren kemi nënshkruar “Marrëveshje Bashkëpunimi”

5	disa shtylla janë gati të rrezohen dhe me këtë rrezikohet jeta e fëmijëve si dhe nje person prej komunitetit boshnjak është ne gjendje te rende shëndetësore dhe pa përkujdesje ju kisha lut qe ta ndihmoni me një përkujdesje te veçantë.	Resmije Krasniqi	Adresuar	Pavarësisht përpjekjeve që kam bërë për përmirësimin e gjendjes së krijuar nga shtylla elektrike të cilat paraqesin rrezikshmëri nuk kemi arritur ndonjë mirë kuptim me KEDS-in. Kjo çështje duhet t'i adresohet KEDS-it
6	Shtylla e drurit është e kalbur prandaj kërkoj që që ky rast të hyj në Planin e vlerësimit me rrezikshmëri të lartë, ku grumbulli i telave dhe fërkimi i tyre shpeshherë përcillet me flakë, ku shtëpia e banimit dhe kalimtarët janë në rrezik jete. Rruga: Afrim Bytyqi Arbanë	Hadije Thaqi	Adresuar	Kjo çështje duhet t'i adresohet KEDS-it pasi që KEDS-i është kompetent për çështjen në fjalë.
7	Listat duhen me qenë zyrtare me të gjitha grupet e cenuara (të moshuarit që jetojnë vetëm, personat me aftësi të kufizuara apo fëmi dhe persona pa mbështetje familjare). Dhe këto lista janë aty kur duhet të reagojnë qytetar aktiv si vullnetar bashk me institucionet përkatëse për shpëtim këtyre qytetarëve në nevojë. Të formohen listat edhe për qytetar që dëshirojnë me u angazhu vullnetarisht për njerëz në nevojë apo ndihmë tjetër. Me siguru rezervat të ujit të pishëm gjithmonë se zakonisht në fatkeqësitë smundjet ngjitëse janë pengesa më e madhe. Secila Bashkesi Lokale në qytetet egzistuese duhen me u shëndrru sa më shpejtë në hapsira të sigurta ku vendosen grupet e qytetarëve në nevoj dhe ku i jipet ndihma e parë me barna,plafa apo ushqim dhe shtretëra.	Antigona Shestan	Pjesërisht	Në planin e vlerësimit të rrezikut janë të përfshirë të gjitha masat që duhet të ndërmarrën në rast të fatkeqësive natyrore. Poashtu duke u bazuar në vlerësim të rrezikut do të Hartohet edhe Plani Operativ Lokal ku do të përfshihen të dhëna të detalizuara.
8	Rrënimin e disa shtëpive të vjetëra dhe pjesërisht të rrënuara. Mundësisht në bashkëpunim me pronarët të veprohet në të ardhmen me qëllim që të mos na ndodhe ndonjë fatkeqësi me fatalitet humbjen e një jete njeriu. Të evitohet rrjedha e ujit në magjistralen Prizren – Kukës në fshatin Vërmicë ku tani dimrit paraqet rrezik pasi që temperaturat janë nën zero dhe bëhet akull rruga. Është një përrua në mes të fshatit i cili kur ka të reshura shtohet uji dhe dele jashtë vendit të cilin është mirë të rregullohet edhe kjo.	Bujar Pulaj	Pjesërisht	Këto kërkesa pranohen pjesërisht pasi që shtëpitë janë në pronë private. Poashtu duke u bazuar në vlerësim të rrezikut do të Hartohet edhe Plani Operativ Lokal ku do të përfshihen të dhëna të detalizuara.

Shkurtesat:

F-Femra


M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në takimin e parë,
4. Lista e zyrtarëve pjesëmarrës në takimin e dytë,
5. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga :


Haziz Krasniqi



NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen të gjithë banorët e Komunës së Prizrenit për organizimin e konsultimit publik për Projekt-Planin e Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit

Data : 11.12.2024

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë)

Ora : 11:00



Të dashur qytetarë/e,

Komuna e Prizrenit përmes grupit punues për hartimin e Projekt-Planit për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit. Nr. 01/011-5643 dhe Udhëzimet Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-Planin e Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **03.12.2024** deri me datën: **18.12.2024**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **11.12.2024**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Bardhë) me fillim në ora **11:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri me datën **18.12.2024** në ora **16:00**, në emailat e zyrtarëve: Ramize.Shala@rks-gov.net, Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Për më shumë detaje për dokumentin, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/>

Platformën për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>


Ymer Berisha

Udhëheqës i Njësise për Komunikim me Publikun



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 736/24 Dt. 03.12.2024



KAMU BİLDİRİSİ

Prizren Belediyesi için doğal afetler ve diğer afetlerden kaynaklanan riskin değerlendirilmesi-Taslağı ile ilgili kamu istişarenin düzenleneceği tüm Prizren Belediyesinin tüm sakinlerine duyurulur

Tarih :11.12.2024

Yer: Belediye Meclis toplantı salonunda (Beyaz Ev)

Saat : 11:00

Sevgili vatandaşlar,

03/L-040 sayılı Yerel Öz Yönetim Kanun'un, 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü ve 04/2023 sayılı Belediyelerde Açık Yönetim ile ilgili İdari Yönergenin (YYİB) gereğince Prizren Belediyesi için doğal afetler ve diğer afetlerden kaynaklanan riskin değerlendirilmesi-Taslağın hazırlanmasına yönelik çalışma grubu aracılığıyla işbu duyuruyu sunmaktadır:

Prizren Belediyesi için doğal afetler ve diğer afetlerden kaynaklanan riskin değerlendirilmesi-Taslağı ile ilgili vatandaşlarla kamu istişarenin düzenlenmesi için

KAMU BİLDİRİSİ

Söz konusu belge **03.12.2024 - 18.12.2024** tarihine kadar kamu istişarede olacaktır. Halkla kamu istişare ise **11.12.2024** tarihinde Belediye Meclisin toplantı salonunda (Beyaz Ev) saat **11:00'de** başlamak üzere düzenlenecektir.

Yorum ve önerilerinizi **18.11.2024** tarihinde saat **16:00'ya** kadar: Ramize.Shala@rks-gov.net , Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net ve Haziz.Krasniqi@rks-gov.net .

Belge ile ilgili daha fazla bilgi için aşağıdaki siteleri ziyaret edebilirsiniz:

Resmi web sitenin kamu istişare yönetmelikler kısmında:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/>

Kamu İstişare Platformu:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Ymer Berisha

Halkla İletişim Birim Yöneticisi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01.12.2024 No: 736/24 Dt. 03.12.2024




JAVNO **OBAVEŠTENJE**

Obaveštavaju se svi građani Opštine Prizren za organizovanje javne konsultacije za Projekat-Procena rizika od prirodnih nepogoda i drugih nepogoda za Opštinu Prizren

Dana: 11.12.2024

Mesto: Sala za sednice Skupštine Opštine (Bela Kuća)

Vreme: 11:00



Poštovani građani,

Opština Prizren je preko radne grupe za izradu projekta-procena rizika od prirodnih nepogoda i drugih nepogoda za opštinu Prizren, na osnovu Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu, Statut opštine Prizren. br. 01/011-5643 i Administrativnog uputstva (MALS) br. 04/2023 za Otvorenu Administraciju u Opštinama, obaveštava

JAVNO OBAVEŠTENJE

U vezi sa organizovanjem javnih konsultacija sa građanima za Projekat-Procenu rizika od prirodnih nepogoda i drugih nesreća za Opštinu Prizren

Ovaj dokument će biti na javnoj konsultaciji od **03.12.2024.** do datuma: **18.12.2024.** godine, dok će se javna konsultacija sa građanima održati **11.12.2024.** godine, u sali za sednice Skupštine opštine (Bela kuća) sa početkom od **11:00** časova.

Vaše komentare i sugestije možete slati do datuma **18.12.2024** u **16:00**, na e mail službenika: Ramize.Shala@rks-gov.net, Adelina.Hoxhaj@rks-gov.net i Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Za više detalja o dokumentu, možete posetiti linkove:

Službeni portal u rubrici planovi na javnoj konsultaciji:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konsultime-publike/planet-ne-konsultim-publik/>

Platforma za javne konsultacije:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/kkprizren>

Ymer Berisha

Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01. 736/24. Dt. 03.12.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunes Presednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 265/23 Dt. 13.04.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, kryetari i Komunës, mori këtë:


V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për Planin e Vlerësimit të Rrezikut në komunën e Prizrenit. Për anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

- 1.1. Ramize Shala,Drejtorja e Emergjencës dhe Sigurisë..... kryesuese.
- 1.2. Urim Daka,Drejtorja e Emergjencës dhe Sigurisë..... anëtar.
- 1.3. Haziz Krasniqi,Zyra e Kryetarit, anëtar.
- 1.4. Përparim Shala,Drejtorja e Shërbimeve Publike, anëtar.
- 1.5. Rrahim Destani,Drejtorja e Inspektorateve, anëtar.
- 1.6. Sami Vehapi,Drejtorja e Administratës, anëtar.
- 1.7. Halil Lika,Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, anëtar.
- 1.8. Jahja Baca,Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës, anëtar.
- 1.9. Fatlum Berisha,Drejtorja e Shëndetësisë, anëtar.
- 1.10. Enver Kryeziu,Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar.
- 1.11. Artan Gashi,Drejtorja e Gjeodezisë dhe Kadastrës, anëtar.
- 1.12. Jakup Kastrati,Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar.
- 1.13. Zana Belloda,Drejtorja e Urbanizmit dhe Plan. Hapës., anëtare.
- 1.14. Sherife Çengaj,Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtare.
- 1.15. Vetan Xhemaj,Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit, anëtar.
- 1.16. Sherif Sallahu,KEDS në Prizren, anëtar.
- 1.17. Vehbi Zekolli,Drejtorja Rajonale e Policisë në Prizren, anëtar.
- 1.18. Fejzullah Berisha,Brigada e Zjarrfikësve, anëtar.
- 1.19. Urim Bytyqi,HidroRegjioni Jugor, anëtar.
- 1.20. Ismail Krasniqi,Kryqi i Kuq në Prizren, anëtar.
- 1.21. Xhevat Elezkurtaj,QKMF, anëtar.
- 1.22. Hekuran Vezgishiti,Spitali Regjional në Prizren, anëtar.
- 1.23. Kujtesa Godeni Skenderi,QRTK, anëtare.
- 1.24. Riza Poniku,EkoRegjioni, anëtar.
- 1.25. Përfaqësues të FSK, anëtar.
- 1.26. Përfaqësues të OJQ-së, anëtar.

2. Detyrat e anëtareve të Grupit Punues janë: që në bashkëpunim me kryesuesen e këtij Grupi dhe akterët tjerë relevant, të bëjnë vlerësimin planin e vlerësimit të rrezikut për institucionin apo departamentin ku është i punësuar dhe që është caktuar me këtë vendim.
2. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.
 - Të emëruarve.
 - Arkivës së Kryetarit.



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **zyrtareve** pjesëmarrës në takimin e Grupit Punues për Planin e Vlerësimit të Rrezikut në Komunën e Prizrenit.

Takimi i parë.

Data e mbajtjes së takimit : 24 .04 .2023

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita e punës	Nënshkrimi
1	Unim	Bytyçi	Departamenti Teknik PZH, HRJ	
2	Shenif	Sallahaj	Kordinatori i mirëmbajtjes, KEJS	
3	VERSIH	ZEKOCI	POLICIA KOSOVES KOMANDANT I SP-PRIZREN	
4	LEFRAT	ELEZKURTAJ	DREJTORI QKRTF	
5	HEKURAN	VEGGISH	SHF, REPARTIT TE EMERGENCES SPITALI BERGUTHISEM PRIZREN	
6	SATI	VEHABI	UNITETE QES / LOGJISTIKES	
7	JAHJA	BACA	ZYRTAR PËR FURNIZIM DHE LOGJISTIK D.K.A	
8	HALIL	LIRA	ZYRTAR I LARTE MENAXHE FINANCIAR DHE KONTROLIT	
9	EROLL	SHABANI	OJQ "EC Ma Ndryshe"	
10	PERPARIM	SHALA	DSHP-PRIZREN	

Përgatiti:
HAZIZ KRASHOTI

Nënshkrimi:



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **zyrtareve** pjesëmarrës në takimin e Grupit Punues për Planin e Vlerësimit të Rrezikut në Komunën e Prizrenit.

Takimi i parë.

Data e mbajtjes së takimit : 24.04.2023

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita e punës	Nënshkrimi
1	ZANA	BEUODA	D. U. PH - zyrtare	
2	SHERIFE	ÇENGAI	DTZHE - zyrtare	
3	KUTESA	GODENI SKENDERI	ORTK - PRIZREN	
4	ISHANL	KRASNIQI	SEKRETAR - KRYQI, KUA	
5	URIM	DAKAI	DES	
6	Romize	Shala	DES	
7	HAZIZ	KRASNIQI	ZIP	
8				
9				
10				

Përgatiti:

HAZIZ KRASNIQI

Nënshkrimi:



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **zyrtareve** pjesëmarrës në takimin e Grupit Punues për Planin e Vlerësimit të Rrezikut në Komunën e Prizrenit.

Takimi i dytë.

Data e mbajtjes së takimit : 20.09.2023

Nr	Emri	Mbiemri	Pozita e punës	Nr.Tel	Nënshkrimi
1	Ramize	Shala	Drejtoreshë e Emergjencave dhe Sigurisë	04	R. Shala
2	Urim	Daka	Zyrtar në Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri	04	
3	Haziz	Krasniqi	Zyra e Kryetarit	04	H. Krasniqi
4	Përparim	Shala	Zyrtar në Drejtorinë për Shërbime Publike		P. Shala
5	Rrahim	Destani	Zyrtar në Drejtorinë e Inspeksionit		R. Destani
6	Sami	Vehapi	Zyrtar në Drejtorinë e Administratës	04	
7	Halil	Lika	Zyrtar në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave		H. Lika
8	Jahja	Baca	Zyrtar në Drejtorinë e Arsimit	04	J. Baca
9	Fatlum	Berisha	Zyrtar në Drejtorinë e Shëndetësisë	04	F. Berisha
10	Enver	Kryeziu	Zyrtar në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale		E. Kryeziu
11	Artan	Gashi	Zyrtar në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit	04	A. Gashi
12	Jakup	Kastrati	Zyrtar në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural		J. Kastrati

13	Zana	Belloda	Zyrtare në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinorë	04		
14	Sherife	Çengaj	Zyrtare në Drejtorinë e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik	04		
15	Veton	Xhemaj	Zyrtar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit			
16	Sherif	Sallahu	Zyrtar-KEDS-Prizren	04		
17	Vehbi	Zekolli	Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren			
18	Fejzullah	Berisha	Zyrtar në Brigada e Zjarrfikëseve-Prizren	04		
19	Urim	Bytyqi	Zyrtar në HidroRegjioni Jugor-Prizren			
20	Ismail	Krasniqi	Zyrtar në Kryqin e Kuq në Prizren			
21	Xhevat	Elezkurtaj	Zyrtar në QKMF-Prizren			
22	Hekuran	Vezgishti	Zyrtar në Spitalin Regjional të Prizrenit	04		
23	Kujtesa	Godeni-Skenderi	Zyrtare në QRTK-Prizren	04		
24	Riza	Poniku	Zyrtar në EkoRegjion-Prizren	04		
25			Zyrtar i FSK-së	04		
26			Zyrtar i OJQ-së	04		
27	Idriz	Shala	Zyrtar i OE Globi Globi Consulting	04		
28			Zyrtar i OE Globi Consulting	04		
29						
30						
31						
32						



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Planin e
Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin
e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: **11.12.2024.**

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	Resmije	Krasniqi	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
2	BEKIM	TAHIRI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
3	SHERIFE	GENCO	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
4	AGRON	TAFI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
5	SOJAT	SELIMI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
6	LINDA	SIMITIN	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
7	ENVER	KRYEZU	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
8	YRUM	ASANI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
9	EGZONA	GRASHEVCI	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
10	HAZIR	KRASNIQI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
11	ARTON	GASHI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	A. GASHI
12	TEUT	BERISHA	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
13	HYSEN	THAGI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
14						
15						



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Lista e nënshkrimeve e **qytetarëve** pjesëmarrës në konsultimin publik për: Projekt-Planin e
Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit.

Emaili dhe numri i telefonit do të përdoren për t'ju dërguar njoftime-ftesa për organizimin
e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike.

Data e mbajtjes së konsultimit: **11.12.2024.**

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr.Tel	Email	Gjinia	Nënshkrimi
1	SINON	VESOLI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
2	NEXHIBE	DAUTI KANLIMIR	[REDACTED]	[REDACTED]	F	[Signature]
3	ISMET	KUTENI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
4	ROFI	AZORI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
5	XHEVDOT	IBRAHIM	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
6	ATV APRENALINA	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
7	BLERIM	GASHI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
8	ESAT	SOPU	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
9	[Signature]	PRENKA	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
10	HALIT	KRASNIQI	[REDACTED]	[REDACTED]	M	[Signature]
11						
12						
13						
14						
15						



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

01 Nr. 770/24 Dt. 13.12.2024

**Procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik për Projekt-Planin e
Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në
Komunën e Prizrenit**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Planit të Vlerësimit të rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Prizrenit, grupi punues ka këtë përbërje: Ramize Shala, kryesuese; Urim Daka, anëtarë; Haziz Krasniqi, anëtarë; Përparim Shala, anëtarë; Rrahim Destani, anëtarë; Sami Vehapi, anëtarë, Halil Lika, anëtarë; Jahja Baca, anëtarë; Fatlum Berisha, anëtarë; Enver Kryeziu, anëtarë; Artan Gashi, anëtarë; Jakup Kastrati, anëtarë; Zana Belloda, anëtare; Sherife Çengaj, anëtare; Vetan Xhemaj, anëtarë; Sherif Sallahu, anëtarë; Vehbi Zekolli, anëtarë; Fejzullah Berisha, anëtarë; Urim Bytyqi, anëtarë; Ismail Krasniqi, anëtarë; Xhevdet Elezkurtaj, anëtarë; Hekuran Vezgishti, anëtarë; Kujtesa Godeni-Skenderi, anëtare; Riza Poniku, anëtarë; Përfaqësues i FSK-së, anëtarë dhe Eroll Shabani-OJQ Ec Ma Ndryshe, anëtarë.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **03:12.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/12/Njoftimi-per-konsultim-publik.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/12An8q8xrnQ/>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-planin-e-vleresimit-te-rrezikshmerise-nga-fatkeqesite-natyrore-dhe-fatkeqesite-tjera-per-komunen-e-prizrenit/>

Konsultimi ka filluar në orën : 11:10

Ymer Berisha Udhëheqës së Njesisë për Komunikim me Publikun, ka bërë hapjen e konsultimit publik duke thënë se kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të kryetarit të komunës si sponsorues i kësaj politike publike, i këtij dokumenti të përshëndes pranin tuaj me prezencë fizike në këtë konsultim publik, përshëndesim edhe të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit që në pamundësi për të qenë prezent fizikisht, në këtë rast mediat lokale e bëjnë të vetën dhe jemi me zërin e dokumentit në secilën familje të secilit qytetarë.

Me kërkesë të kryetarit, jemi duke provuar të bëjmë më të mirën sa i përket vendimmarrjes, pra vendimmarrja të jetë demokratike, të jetë e konsultuar me të gjitha palët e interesit, të ketë kohën e mjaftueshme për të gjithë qytetarët që mendojnë që mund të japin kontributin e tyre gjatë hartimit të dokumenteve, gjatë shkrimit të dokumenteve që bënë komuna e Prizrenit.

Egzona Grajçvci, eksperte e për GIS, ka bërë prezantimin e planit duke thënë se:

-“Vlerësimi i rrezikshmërisë nënkupton analizën sasiore dhe cilësore të natyrës dhe rrethanave tjera për dukuritë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ”

-Si çdo pjesë e Kosovës edhe komuna e Prizrenit mund të ballafaqohet me fatkeqësitë natyrore

-Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare, ngritjes së kapaciteteve për mbrojtje dhe shpëtim, masave parandaluese, zhvillimin e programeve për një jetë më kualitative dhe më të sigurt, hartohet dokumenti i vlerësimit të rrezikshmërisë nga **fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera**.

-Komuna e Prizrenit është përgjegjëse për organizimin e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në kufijtë territorial të përgjegjësisë të saj.

Pozita gjeografike, madhësia territoriale e komunës së Prizrenit

Territori i komunës së Prizrenit zë një sipërfaqe prej 627 km² Kufizohet me komunat e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpçës dhe Dragashit si dhe më Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Në komunën e Prizrenit janë 76 vendbanime zyrtare gjendet në lartësi mbidetare prej 300 metra ku disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë prej 2000 m të lartësisë mbidetare.

SHTRIRJA E VENDBANIMEVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT SIPAS LARTËSISË MBIDETARE

Territoret e banuara në Komunën e Prizrenit janë ato duke filluar prej 308 metra, duke veçuar fshatin Nashec, Zojz, etj., deri në 1190 metra, tek fshati Gornjasellë

DEMOGRAFIA

Komuna e Prizrenit përbëhet prej 76 vendbanimeve, në të cilat jetojnë 193.806 banorë (sipas vlerësimit të popullsisë në vitin 2021), Komuna e Prizrenit ka dendësi mesatare rreth 309 b/km²

Bazuar në statistikat e fundit 2011 Komuna e Prizrenit ka gjithsej **177 781** banorë.

Dhe sipas statistikave rreth 57% të popullatës jetojnë në zonën urbane (Prizren, Dushanovë, Lubizhdë) ndërsa 43 % jetojnë në zonat rurale

DEMOGRAFIA

Në Komunën e Prizrenit ka 53,013 objekte me një dendësi mesatare të banimit prej rreth 309 (b/km²).

DEMOGRAFIA

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, gjendja paraqitet si në vijim: popullsia e re, ajo e moshës nga 0-14 vjeç është e pranishme me 49.199 banorë ose 28 % e popullsisë, grup-mosha aktive (15-65 vjeç) e popullsisë ose popullsia që ka më shumë peshë dhe ndikim në parametrat tjerë të grup-moshave është rreth 117.178 banorë ose 66 % e popullsisë së përgjithshme të Komunës së Prizrenit, kurse popullsia e mbajtur ose jo aktive ka një numër rreth 11.404 banorë apo 6 % e popullsisë së përgjithshme të Prizrenit.

Infrastruktura teknologjike dhe e trafikut Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)

Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rrjet rrugorë prej 1177.3 km rrugë të të gjitha kategorive.

Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës

Infrastruktura teknologjike dhe e trafikut Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)

Ky raport në harta është një tregues i rëndësishëm për planifikimin e rrugëve dhe menaxhimin e qarkullimit të automjeteve në rrjetin rrugor.

Infrastruktura teknologjike dhe e trafikut

Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)

Vlerësimi i sigurisë në trafik në rrugët kryesore në Komunën e Prizrenit është e bazuar në analizën nga të dhënat analitike të ofruara nga sektori i sigurisë, për nivelin e sigurisë së trafikut rrugor në regjionin e Prizrenit. Të dhënat janë paraqitura ndë vite kanë për qëllim vlerësimin dhe trendin e ngjarjeve /aksidenteve rrugore si dhe pasojave sipas metodës krahasuese.

RESHJET E DËBORËS DHE NGRICAT

Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës dhe ngricave, Duke u bazuar në reshjet e një pas njëshme me vite konsiderojmë se zonat me të prekura dhe me problematike nga ngricat dhe dëbora janë rrugët në pjesën Jugore dhe Lindore të komunës, të pjesa ku është terreni me i thyer dhe në vendbanimet që janë në lartësi me të madhe mbidetare.

Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet:

Territori i Komunës së Prizrenit sipas vlerësimit të rreziqeve, ka një rrezikshmëri nga vërshimet, ku kryesisht hynë vërshimet nga lumenjtë, fryrja e përrenjve dhe ngritja e nivelit të ujërave nëntokësor gjatë stinëve me të reshura.

Karakteristikat hidrografike nga aspekti i rrezikshmërisë së territorit nga vërshimet dhe përmbajtjet determinohen nga një mori faktorësh ndër të cilët dallojmë:

Mos-rregullimi i infrastrukturës në shtretërit e lumenjve të lumit

Degradimi i shtretërve të lumenjve - gjërmimet dhe eksploatimet e pakontrolluara të resurseve natyrore – rërës dhe masës drunore

Ndërtimet e egra të shtëpive të banimit dhe objekteve tjera në dhe rreth shtratit të lumenjve,

Ndikimi i faktorit njëri në kuptimin e papërgjegjësisë qytetare në hedhjen e mbeturinave inerte në shtretërit e lumenjve, sidomos, tek pikat kritike si : urat, kanalet, tubacionet etj.

RRJETI HIDROGRAFIK-KOMUNA E PRIZRENIT

Në komunën e Prizrenit rrjeti hidrografik është relativisht i dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve njerëzore.

Lumi Drini i Bardhë, edhe pse nuk buron në komunën e Prizrenit, të gjitha përroskat dhe lumenjtë derdhen në të.

Identifikimi i rreziqeve nga vërshimet

Territori i Komunës së Prizrenit sipas vlerësimit të rreziqeve, ka një rrezikshmëri nga vërshimet, ku kryesisht hynë vërshimet nga lumenjtë, fryrja e përrenjve dhe ngritja e nivelit të ujërave nëntokësor gjatë stinëve me të reshura.

Masat parandaluese nga vërshimet

Si masë parandaluese nga vërshimet, Grupi Punues për hartimin e dokumentit të vlerësimit të rrezikshmërisë rekomandon këto masa parandaluese:

Të bëhet pastrimi dhe rregullimi i shtretërve të disa përrockave të cilat janë të degraduara nga materiale inerte;

Inspektorati komunal duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për inspektimin dhe rritjen e kontrollimit të mirëmbajtjes së argjinaturave dhe kanaleve kulluese nga bujqit e papërgjegjshëm në tokat bujqësore përgjatë lumit, e në veçanti pengimin e ndërtimeve dhe veprimeve pa planifikim dhe leje urbane që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet.

Të ndalohet ndërhyrja e pa autorizuar dhe denigruese (ndryshim i rrjedhës) e lumenjve në Komunën e Prizrenit që mund të çojnë deri në rritjen e rreziqeve nga vërshimet;

Të hartohen programe dhe projekte konkrete vetë dijesuese të popullatës si dhe ndërmarrja e masave ligjore ndaj të gjithë atyre keqbërësve të cilët hedhin mbeturina në vende të palejuara;

Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore

Karakteristikat sizmike të zonave dhe rreziku sizmik

Tërmeti pasqyron luhatjen e pllakave të tokës të nxitura nga shkaqe natyrore e që janë pasojë e lirimit të brendshëm të energjisë së tokës.

Komentet e qytetarëve:

Blerim Gashi nga kompania “ATV Adrenalina”, duke thënë se konsiderojmë se ky është një hap shumë i rëndësishëm për bashkëpunimin midis institucioneve, qytetarëve dhe bizneseve private, sidomos për raste emergjente dhe situata të jashtëzakonshme.

“ATV Adrenalina” shpreh gatishmërinë dhe vullnetin për të dhënë kontributin e saj për të mirën e përbashkët të qytetit tonë. Kompania jonë zotëron 7 motorra ATV të specializuar për terrene të vështira malore dhe kushte të pafavorshme si borë, shi dhe shtigje të thepisura. Ky lloj mjeti transportues mund të jetë një vlerë e shtuar për rastet emergjente dhe për të mbështetur ekipet tuaja në situata të veçanta.

Përfitimet nga motorët tanë ATV për Komunën e Prizrenit dhe komunitetin përfshijnë:

Transportim i shpejtë i personelit mjekësor në zona të paarrtshme me automjete të zakonshme.

Dërgimi i paketave emergjente, si ushqime, ujë dhe materiale të tjera të nevojshme në raste krizash.

Mbështetja e stafit policor dhe ekipeve të zjarrfikësve, duke përfshirë transportimin e personelit, pajisjeve të punës dhe burimeve të tjera të domosdoshme.

Reagim i shpejtë në raste të fatkeqësive natyrore, duke lehtësuar arritjen në vendndodhjet më të izoluara të komunës, si fshatra malore apo terrene të thella.

Gzim Gashi nga kompania “ATV Adrenalina”, pikat në të cilat ne mund të kontribuojmë janë e që janë në raste emergjente:

Motorrat e kompanisë sonë janë me katër rrota dhe ata shkojnë nëpër terena ma të theksme malore, në shi, në borë në të gjitha kushtet, pra janë shumë praktik dhe të specializuar për me shku në terrene ku nuk shojnë makinat normale apo edhe zyrtare.

Ne kemi parashikuar që në bashkëpunim me ekipet e rasteve emergjente si : personeli mjekësor nëpër fshatra të ndryshme në raste të caktume, paketa emergjente, motorrat kanë bagazh dhe mund të transportojmë edhe disa kilogram me paketa të ndryshme, ekipe mjekësore, ekipe emergjente, ekipe policore pra të gjitha në koordinim me ekipet emergjente, se çka neve mund të ofrojmë, kjo për faktin se ne jemi prezent në gjitha bjeshkët e Prizrenit, duke marrë parasysh nga Guri i Zi, Pashtrik dhe të gjitha bjeshkët që janë përreth .

E shohim se cila makinë mund të shkoj dhe cila nuk mund të shkoj, ne jemi prezent aty ku nuk shkojnë makinat ma ushtarake këtu pse edhe ne të japim një pikë-ndihmë. Ne nuk posedojmë ekip personal, përveç motorrave ne nuk kemi njerëz, nëse komuna e shih të arsyeshme në bashkëpunim me ekipet emergjente, ne i kemi pikat se çka mund të bëjmë, ti trajnojmë ekipet e caktume nga komuna që mund ti marrin motorrat 24 orë në dispozicion për rast nevojë (FSK, Policia, Zjarrfikësit), secila ekipe mundet me pas motorrin, ne mund t’ja ofrojmë trajnimin dhe ata mund ti marrin motorrat në raste emergjente. Kjo është ajo që ne e kemi planifikuar për ndihmë për nevojat e qytetit të Prizrenit.

Simon Veseli-Zonja Grajqevci e ka përgaditu shume bukur projekt Planin e Vlerësimit te rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Disa here kemi bërë kërkesë ne Kuvendin Komunal te Prizrenit për te reshurat atmosferike, kam kontaktuar edhe me drejtoreshën Ramize Shala si dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike qe disa vite qe nga koha kur është ndërtuar autostrada e cila kalon perfundi fshatit Shpenadi ne te cilën është ngrit niveli i tokës për shkak te hedhjes se gurëve te shumte dhe kur ka vërshime dëmtohet familja Shtufi nga te reshura.

Ka nevojë për një siguri te veçantë ne te cilën duhet te eliminohet kjo dukuri qe çdo vit po ndodh me një mur mbrojtës me thellu lumin qe është ngrit gjate punimeve te autostradës.

Egzona Grajqevci, ne kuadër te kompanisë ka qene një ekip qe ka kontaktuar direkt me përfaqësuesit e fshatit Shpenadi, jane te evidentune qe ka pas vërshime. Ekipa ka marr te dhëna dhe do te pasurohet pjesa tjetër e këtij plani.

Agron Tafa, kryetar i degës i shoqatës se pensionistëve te TMK-se, FSK-se ne Prizren. Jemi te gatshëm të jemi pranë institucioneve ku Drejtorisë për Siguri dhe Emergjenca ju kemi ofruar gjithmonë alternative për specialiste te fushës sonë për trajnime për mbrojtjen nga rreziqet e ndryshme. Kemi obligim moral me i mbështet institucionet.

Resmije Krasniqi, disa shtylla janë gati të rrezohen dhe me këtë rrezikohet jeta e fëmijëve si dhe një person prej komunitetit boshnjak është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe pa përkujdesje ,ju kisha lutur që ta ndihmoni me një përkujdesje të veçantë.

Konsultimi ka përfunduar në orën: 12:00

Video incizimi i konsultimit: <https://www.facebook.com/share/v/14htPobbYJ/>

Procesmbajtës/e:

HAZIR KRASNIQI
